



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NDËRMARRJA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Kamëz, më 21.09.2026

PROCES - VERBAL – Tipi i Kontratës-Punë Publike

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Furnizim-Vendosje Semaforë në Lagjen Administrative Bathore”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) :

Semafor 34996100-6

Instalime të semaforëve 45316212-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 5,000,000 (pesë milion) lekë pa tvsh.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz**, ka hartuar proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme mbështetën në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objektprokurimi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros për të paktën (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. *Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenin 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara përparaqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, **Ndermarrja e Sherbimeve Publike Kamëz**, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të ulët se **50%** e vlerës së fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë;

a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

ose

b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Neni 55 pika 4/b. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku qartazi përcaktohet se: *“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet*

kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”*. Shqyrtimi i licencave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategorite e mëposhtme:

- NP – 11/A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
- NP—12/A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)
- NP - 5/A (Punime nentokesore, ura e vepra arti)
- NS – 18/A (Punime topogjeodezike)
- NS - 5/A (Impiante të sinjalistikes ndricuese të trafikut.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky kriter ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor dhe mbështetës, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedis
- 1 (një) inxhinier Topograf/ Gjeodet/ Markshajder
- 1 (një) inxhinier Elektrik

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë: Për secilin pjestar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë, Kontratë pune e

vlefshme, diplomë, Libreze pune dhe CV, (Drejtuesit teknik te jenë te siguruar sipas legjislacionit ne fuqi).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet disponoje punonjës të specializuar/kualifikuar si më poshtë:

1 (një) punonjes i pajisur me çertifikuar “Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave”, e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara ose nga organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

1 (një) punonjës që disponon çertifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne pune” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores ”Për sigurine në kantier”.

1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë si “ Auditues/ Insepektues i Sigurisë Rrugore (auditin e sigurisë rrugore dhe menaxhimin e pikave të zeza)” lëshuar nga Institucionet Kompetente Shtetërore në përputhje me klauzolat e Direktivës 2008/96/EC ose ekuivalente.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese., si më poshtë: diplomë / Çertifikatat e cituara më sipër dhe Kontrate pune.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda . afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
--------	-------	---------

Kamionçinë me kapacitet mbajtës jo me pak se 1,5 – ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç te integruar	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor (i lëvizshëm)	1 copë	Pronësi ose me qera
Karrel per sinjalizim e punimeve ne rruge	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Freze asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese me objekt te percaktuar, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- Per mjetet e vijeimit te paraqitet skeda teknike e perkthyer me qellim verifikimin e llojit te mjetit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Per mjetet qe transportojne mjete te renda duhet te paraqitet certifikata perkatese e leshuar nga institucioni kompetent.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar

duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesi certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:

ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë

ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

ISO 50001:2018 Sistemet e Menaxhimit të Energjisë

- Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zerave të punimeve që do të realizojë.

- Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë të çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi ndërkombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoriteti kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedure që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demostrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet

zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra AK-së.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të plotësojë deklaratën e garancisë për funksionimin e semaforëve për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vite.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 8, pasi Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, gjithashtu ky kriter ka rëndësi për vlerësimin e ofertës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër që pas mbarimit të procesit të punës (*pasi të mbarojë vendosja e semaforit*) dhe të funksionojë çdo gjë në rregull, të rikthejë në gjendjen fillestare rrugën dhe trotuarin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40 pika 8, pasi Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat **1-8** dhe **12-13** sipas preventivit të procedurës së prokurimit, (*për gjuhën e huaj duhet të ketë përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe*).

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentet duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit n. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht dhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat **1-8** dhe **12-13** sipas preventivit të procedurës së prokurimit, katalogët dhe/ose skedat teknike ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike. Katalogët duhet të paraqiten në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht dhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standartet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtëpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Kamëz, **mostra për artikujt 1 dhe 7** objekt prokurimi, si dhe bojën bikomponente pastë në amballazhin original sipas specifikimeve teknike.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtëpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra në zbatim të tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikime teknike.

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testimin) e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se kto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngitur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 40, pika 2, të VKM NR. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementëve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performancë, apo/dhe çdo standart të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/e saj"**.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët ose "ekuivalente".

Data e hapjes dhe zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë më datë:

02.10.2026, ora 11:00, vendi: mënyrë elektronike në www.app.gov.al

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi është mbështetur te grupi i punës i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të veçanta teknike, të procedurës në referencë.

NJËSIA E PROKURIMIT

